

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPALLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurrimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Specialist I (Zëvendësues), Drejtoria Juridike, Sektori Juridik&Ankimimet, (Kategoria III-b).

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); VKB Nr.169, datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.2236, datë 08.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë (Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhsimi nga MAS*);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përbën avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Specialist I ka për detyrë si më poshtë:

- Specialist I varet direkt nga Përgjegjësi i Sektorit.
- Specialist I ka këto detyra kryesore:

- a) Zbaton programin e punës sipas miratimit nga Drejtori i Drejtorisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- b) Jep këshilla, opinione dhe ndihmë juridike, me iniciativë apo sipas kërkesës, për të gjitha strukturat e IMT- së në drejtim të njohjes, interpretimit dhe zbatimit rigoroz të Kushtetutës dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
- c) Jep këshillimin e nevojshëm ligjor dhe opinionin juridik për veprimtarinë inspektuese të IMT sa herë që kërkohet dhe është e nevojshme për vendimmarrje;
- d) Jep këshilla, opinione dhe ndihmë juridike për hartimin e akteve administrative në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
- e) Vë në dispozicion të stafit të IMT- së, të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që i kërkohen;
- f) Angazhohet në përpilimin e urdhreve dhe udhëzimeve të brendshme të Kryeinspektorit.

- g)** Angazhohet në ndjekjen e proceseve kontraktuale, administrative, përmbarimore të cilat i drejtohen IMT-së sipas kërkesave ligjore në fuqi.
- h)** Ndjek në të gjitha shkallët e shqyrtimit apo të gjykimit me autorizim të Kryeinspektorit të gjithë proceset administrative apo gjyqësore, ku institucioni është palë ndërgjyqëse paditëse ose e paditur dhe në raste kur IMT është person i tretë, edhe në bashkëpunim me DPJAL në Bashkinë e Tiranës
- i)** Kontribuon në zqidhjen e kërkesave apo ankesave drejtuar IMT, duke këshilluar strukturat përgjegjëse për trajtimin e tyre në lidhje me çështjet me natyrë ligjore e juridike.
- j)** Ndjek dhe monitoron konfliktet gjyqësore me të cilat IMT është palë ndërgjyqëse duke organizuar punën në mënyrë produktive në rastet kur Institucioni paditet në Gjykatë në të gjitha shkallët e gjykimit.
- k)** Koordinon, mbikqyr dhe siguron në mbrojtje të Interesave të IMT:
 - a. realizimin e përgatitjeve të prapësimeve në Gjykatën e Shkallës së Parë
 - b. kërkesave të ndërmjetëme
 - c. kërkesave ankimore në Gjykatë
- l)** Koordinon ndjekjen e veprimeve proceduriale duke respektuar kërkesat, procedurat dhe afatet ligjore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të BT:
 - për zbatimin e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë
 - përgatitjen e kërkesave përkatëse në rastet e kundërshtimit të kërkesave për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë në Gjykatën e Lartë.
- m)** Monitoron përgatitjen e njoftimeve për marrjen dijeni të subjekteve ankimues në lidhje me vendimet e Kryetarit, struktura akti i të cilave është ankimuar.
- n)** Ndjek shqyrtimin e të gjitha procedurave për ankimet administrative të subjekteve private që kundërshtojnë veprimet e Inspektoratit, sipas kërkesave të eprorit duke ju përbajtur objektivave dhe afateve të përcaktuara.
- o)** Vlerësim juridik i procedurave për kundërvatjet e konstatuara në terren.
- p)** Përgatitje e dokumentacionit dhe kërkesave për lëshim urdhëri ekzekutimi për masat administrative dënim me gjobë, drejtuar gjykatës.
- q)** Ndjekje e procedurës ligjore për vjeljen e gjobave të vendosura nga IMT nëpërmjet shërbimit përmbarimor.
- r)** Sugjeron dhe monitoron përgatitjen e materialeve të duhura informuese për IMT në lidhje me përgatitjen e ankesave ankimore, rekurse, memo, draft vendimeve duke vlerësuar të gjitha mundësitë proceduriale në bashkëpunim me strukturën juridike në Bashkinë Tiranë.

Dokumentat që aplikanti për Specialist I (Zëvendësues) në Drejtorinë Juridike, Sektori Juridik&Ankimimet, duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara (për diplomat jashtë vendit të përcillet njëhsimi nga MAS) ;
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Raport mjeko – ligjor;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografie;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë zyrave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, në adresën : Rr: “Asim Vokshi”, Nd.10, H.4, Ap.3, 1057, Tiranë, afati është deri me datë 20.09.2024 **ora** 14.00.